



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Prilbena/Pudato Received/Delivered	16-02-2023	3 viti god year	
Organi / Njësia Organ / Jednica Org./Unit	No Prof No Prof Prof No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHICK	1871/2023		115



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.20/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.20/2023 të datës 06.01.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit numër:111-1133/3 të datës 23.12.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.02.2023, mori këtë.

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.20/2023 e datës 06.01.2023 e parashtruara nga ankuesi
- II. Shfuqizohet Vendimi Nr.111-1133 i datës 15.12.2022 dhe Vendimi Nr.111-1133/3 i datës 23.12.2023 i Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.
- III. Obligohet Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të rishqyrtoj aplikacionin e ankuesit të datës 08.12.2022, duke marr parasysh të gjeturat si në arsyetim të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesi i punësuar në Komunën e Skenderajt, me datë 05.01.2023 ka parashtruar ankesë përmes e-mailit zyrtar e cila është pranuar me datë 06.01.2023 dhe regjistruar me numër protkoti:76/2023 nën shenjen A.nr.20/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimin Nr.111-1133/3 të 23.12.2023 të Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën e punës Auditor i Brendshëm me numër reference RN00008364 në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.01.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa me datë 24.01.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit, pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën e datës 06.01.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin e datës 05.01.2023 dërguar nga M.L për Këshillin; Çertifikatën e ankuesit të lëshuar nga KAF me titull "Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik" me numër:05-04/25/22 të datës 11.11.2022; Shkresën e vulës së vërtetësisë së datës 17.11.2022 të Autoritetit të Kombëtar të Kualifikimit; Vendimin e datës 23.12.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore; Vendimin e datës 15.12.2022 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore; E-mailin e dërguar nga Instituti KAF për ankuesin; Vendimin me numër:43/2013 të datës 24.04.2013 të Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar; Konkursin e datës 16.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.01.2023; përgjigjen në kërkesë të datës 24.01.2023; Ankesën e ankuesit të parashtruar me datë 15.12.2022 në Njësinë e Burimeve Njerëzore të MAPL-së; Aplikacionin e ankuesit të datës 08.12.2022; Akt emërimit e ankuesit të datës 25.03.2021; Diplomën e ankuesit me numër:5723 të datës 27.10.2015; Diplomën e ankuesit me numër:1969 të datës 30.09.2019; Diplomën e datës 15.06.2011; Anekses Kontratën e Punës të datës 22.04.2016; Përgjigjen në kërkesën e datës 10.02.2022 të Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Skenderajt; Kopjen e lëtërnjoftimit të ankuesit; Vendimin Nr.02-052/01-0039863/20 të datës 14.09.2020 të Kryetarit të Komunës së Skenderajt; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 06.12.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 31.01.2022; Çertifikatën e ankuesit të datës 12.02.2021; Çertifikatën e ankuesit të datës 28.10.2020; Çertifikatën e ankuesit të datës 21.10.2020; Çertifikatën e ankuesit të datës 15.06.2020; Diplomën e ankuesit të datës 12.02.2013; Çertifikatën e ankuesit të datës 22.04.2011; Aplikacionin e kandidatës A.S-P me shkresat e bashkangjitura: Akt Emërimit e datës 03.04.2012; Akt emërimit e datës 25.07.2022; Diplomën e datës 31.10.2013 me numër:3633; Diplomën e datës 24.01.2017 me numër:1078; Çertifikatën e datës 12.10.2016; Diplomën e datës 12.06.2007; Kopjen e lëtërnjoftimit të kandidatës A.S-P; Kontratën e punës të datës 01.06.2022; Letër rekomandimin e datës 11.04.2012; Letër rekomandimin e datës 06.07.2015; Vërtetimin e datës 06.12.2022; Vërtetimin e datës 08.12.2022 të Policisë së Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 15.01.2021; Vendimin e Policisë së Kosovës të datës 17.08.2020; Vendimin e datës 13.03.2020 të

Qeverisë së Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 15.01.2022; Çertifikatën e datës 12.10.2016; Çertifikatën e datës 23.07.2012; Çertifikatën e datës 08.05.2012; Çertifikatën e datës 31.08.2010; Çertifikatën e datës 12.03.2021 me numër:304/2021; Çertifikatën me shifër D-1209 lëshuar nga ShKÇAK; Çertifikatën e datës 23.04.2015; Çertifikatën e datës 26.01.2013; Çertifikatën e datës e datës 29.01.2017; Çertifikatën e datës 14.09.2012; Çertifikatën e datës 30.07.2012; Aplikacionin e kandidatës Sh.Xh me dokumentacionin e bashkangjitur: Akt emërimit e datës 03.06.2012; Diplomën e datës 28.10.2008 me numër:696; Diplomën e datës 09.12.2019 me numër:2140; Kopjen e letërnjoftimit të kandidatës S.Xh; Çertifikatën e datës 01.06.2017 me numër:183/2017; Çertifikatën e lëshuar nga Demos-nëntor 2020; Licencën e datës 05.09.2011 me numër:124/2011; Vërtetimin e datës 28.09.2022 lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Drenasit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me datë 16.11.2022 ka shpallur konkurs për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Auditor i Brendshëm me numër reference RN00008364, ndërsa kriteret e konkursit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në Ekonomik, Juridik, Administratë Publike, Financa Publike me të paktë 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor; Kualifikime të posaçme formale: Çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose çertifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik të lëshuar nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave; Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë.*

Po ashtu nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht aplikacioni i datës 08.12.2022 është konstatuar fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit në fazën e verifikimit paraprak përmes Vendimit numër:111-1133 të datës 15.12.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore, i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit. Tutje, ankuesi kundër Vendimit të datës 15.12.2022 të Divizionit të Burimeve Njerëzore ka parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 23.12.2023 ka nxjerrë Vendimin Nr.111-1133/3 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit të datës 15.12.2023 duke e lënë në fuqi Vendimin të datës 15.12.2022 për refuzimin e aplikacionit në fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se, citoj: *"Meqenëse kriter i konkursit ka qenë që kandidatët të kenë Çertifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose çertifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik të lëshuar nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, NJBNJ në bazë të nenit 45 paragraf 6 ka nxjerrë vendim me të cilën e refuzon ankesën",* duke lënë të kuptoj se Çertifikata për Auditor të Brendshëm që disponon ankuesi të lëshuar nga Instituti KAF nuk është valide në rastin konkret.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dosjen e aplikacionit të ankuesit dhe ka gjetur se i njëjti posedon Diplomën me



numër:5723 përmes të cilës dëshmohej se i njëjti me datë 14.10.2014 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik-Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gjithsejtë 180/Kredi-ETCS, dhe po ashtu posedon Diplomën me numër:1969 përmes të cilës dëshmohej se i njëjti me datë 07.06.2019 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin Ekonomik-Departamenti Banka, Financa dhe Kontabilitet në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" me gjithsejtë 120/Kredi-ETCS. Ankuesi, ndër të tjera posedon Certifikatën të lëshuar nga Instituti KAF me titull "Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik" me numër:05-04/25/22 të datës 11.11.2022, ndërsa sipas Aktit të emërimit të datës 25.03.2021 i njëjti është i punësuar në Komunën e Skenderajt në pozitën e punës "Analist i Buxhetit" që nga datat 25.03.2020, andaj nga se u tha më lartë në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, ankuesi i ka plotësuar kriteret e konkursit të datës 16.11.2022 të shpallur nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për pozitën Auditor i Brendshëm (RN00008364) pasi që i njëjti ka mbaruar studimet themelore dhe Master në Fakultetin Ekonomik dhe ka grumbulluar gjithsejtë 300/Kredi-ETCS, po ashtu ka mbi dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën e kërkuar, sikurse posedon edhe Çertifikatën e lëshuar nga institucioni vendor KAF me titull "Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik" me numër:05-04/25/22 të datës 11.11.2022.

Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit, nuk ka dhënë arsytim të bazuar dhe të mjaftueshëm ligjor lidhur me faktin se certifikata e ankuesit e lëshuar nga Instituti KAF me titull "Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik" nuk i plotëson kriteret e përcaktuara si në konkursin e datës 16.11.2022, pasi që në konkursin në fjalë nuk ishte specifikuar asnjë detaj apo koment shtesë lidhur me atë se cilat janë institucionet e përcaktuara vendore që kanë të drejtë të lëshojnë një certifikatë të tillë, madje institucioni që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit në rastin konkret Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka mundur që t'i drejtohet me shkrim Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve për të verifikuar faktin nëse Instituti KAF ka të drejtën të lëshojë një certifikatë të tillë, përderisa ankuesi në cilësi të provës shtesë me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill ka ofruar edhe e-mailin e dërguar nga Instituti KAF në të cilin potencohet fakti që të njëjtit janë të akredituar për programin e Auditorëve të Brendshëm nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve që nga viti 2016, dhe po ashtu të njëjtit në shkresën e lartcekur theksojnë faktin se, citoj: "në bazë të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare (nenet 1.2, 16 dhe 17) dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.09/2019 për kriteret dhe Procedurat për Akreditim (neni 18) kualifikimi për " Auditor i Brendshëm në Sektorin Publik dhe Privat" nga Instituti paraqet kualifikim profesional me njohje të plotë. Po ashtu në mbështetje të plotë edhe në nenin 22 paragrafi 2 të ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

Rrjedhimisht, mbështetur në shqyrtimin e aplikacionit të ankuesit, analizimin e pretendimeve ankimore të tij, si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit vije në përfundim se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit në fazën e verifikimit paraprak duke u thirr në nenin 45 paragrafi 6 të Rregullores NR.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës e ka përdorur në mënyrë të paligjshme diskrecionin që iu ka njohur nga ligji, ngase sikurse u theksua edhe lartë nuk ka dhënë asnjë argument bindës se certifikata e ankuesit e lëshuar nga institucioni vendor KAF me titull "Auditor i Brendshëm në Sektorin Privat dhe Publik" me numër:05-04/25/22 të datës

11.11.2022 nuk i plotëson kriteret e përcaktuara, andaj si rrjedhojë në mbështetje të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme", Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi i datës 15.12.2022 sikurse edhe Vendimi Nr.111-1133/3 i datës 23.12.2023 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, janë të paligjshme, kështu që vendosi për shfuqizimin e tyre si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa detyroj Divizionin e Burimeve Njerëzore që të rishqyrtoj aplikacionin e ankuesit të datës 08.012.2022 sipas të gjeturave dhe vërejtjeve të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.2 dhe paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër: A.nr.20/2023

Flakron Gashi

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

